

Ekskluzive

Ekskluzive | Të shtëna me armë në restorantin “Roza” në Viti – 58-vjeçari pranon se qëllloi pesë herë në ajër, përfundon në ndalim



Sinjali.com

01 Gusht 2026 10:16



Një aheng në një restorant në Viti është shoqëruar me të shtëna me armë, ndërsa Policia ka arrestuar një 58-vjeçar, i cili pranoi se kishte qëlluar disa herë në ajër.

Sinjali mëson se i dyshuari është **lbush Mustafa**, rreth 58-vjeçar.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur pak para mesnatës së 31 korrikut, rreth orës 23:55, në restorantin “Roza”, në rrugën “Rexhep Bislimi” në Viti.

Pas raportimit për të shtëna me armë, njësitë policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes. Gjatë veprimeve policore, lbush Mustafa ka pranuar se kishte qëlluar pesë herë në ajër me një armë me gaz të tipit “Zoraki”, të cilën më pas e ka dorëzuar vullnetarisht.

Arma është sekuestruar në cilësinë e provës materiale, ndërsa për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit.

Me urdhër të Prokurorit, ndaj lbush Mustafës është iniciuar procedurë për veprat penale “Armëmbajtje pa leje” dhe “Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”, ndërsa ai është ndaluar për 48 orë. Hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera